



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: ± 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 781/26

Sekretariati i Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik duke u bazuar në nenin 98 paragrafi 2 si dhe nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me numër 781/26, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE OE Pro&Co Group, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial Opterushë, me nr. të prokurimit: 204-22-12762-5-1-1, të inicuar nga AK – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më: 15.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET, si e pa bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE Pro&Co Group me nr. Unik: 811092254, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial Opterushë, me nr. të prokurimit: 204-22-12762-5-1-1, sepse nuk janë plotësuar kushtet e parapara në nenin 99.2 të LPP-se. AK ka të drejtën ligjore dhe mund të kërkoj ta realizoj sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) pran Gjykatës kompetente.

ARSYETIM

Kërkesa e AK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë:

1. Autoriteti kontraktues përmes kërkesës së datës: 12.06.2025, ka kërkuar marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se, ndaj OE Pro&Co Group, me arsyetimin se me operatorin ekonomik kemi nënshkruar kontrate, për aktivitetin me titull: Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial Opterushë, me nr. të prokurimit: 204-22-12762-5-1-1 dhe i njëjti në vazhdimin nuk është përgjigjur kërkesave të AK-se, për përmirësimin e shërbimeve dhe përfundimin e punimeve sipas kontratës.
2. Më tutje AK – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në kërkesën e datës: 12.06.2025, ka sqaruar dhe njëherit ka bashkangjitur disa email-a, kërka dhe dëshmi tjera ku i ka kërkuar nga operatori ekonomik vazhdimin dhe përfundimin e punimeve.

Me datë 17.03.2023, është realizuar vizita në terren për projektin në fjalë. Gjatë kësaj vizite OE është informuar për gjendjen aktuale në terren. Projekti në formë fizike iu është dorëzuar menaxherit të OE-së, ndërsa projektin në formë elektronike CD e kërkuam nga zyrtari përgjegjës nga Komuna e Rahovecit. Njëkohësisht, nga operatori ekonomik është kërkuar që të fillojë mobilizimin në terren për fillimin e punimeve sipas kushteve të kontratës. Data zyrtare e fillimit të punimeve në ndërtimin e Parkut është me 27.03.2023, ku OE ka nisur punën me intensitet të kënaqshëm dhe ka vazhduar sipas planit dinamik të kontratës. Si rezultat i kësaj nga fundi i vitit 2023, kemi biseduar me OE dhe i'u kemi ofruar mundësi që të bartet buxheti i planifikuar për vitin 2024 në vitin 2023, nëse edhe OE ka gatishmëri që të përfundojë tërë projektin brenda vitit 2023, por OE nuk ofroi gatishmëri.

Pas ndërprerjes së përkohshme të punimeve në fund të vitit 2023 për shkak të sezonit dimëror, dhe pas përmirësimit të kushteve atmosferike në fillim të muajit shkurt 2024, është kërkuar që punimet të rifillojnë nga data 08.02.2024. Me datë 09.02.2024 jemi njoftuar nga menaxheri i OE përmes emailit se për shkak të përgatitjes së makinerisë (servisimit), punimet nuk mund të fillojnë. Duke pasur parasysh se rifillimi i punimeve filloi me krijim vonesash, me datë 26.02.2024 kemi ftuar për mes telefonit menaxherin e kontratës i cili bashkë me përfaqësuesin e OE kanë ardhur në takim në zyrat e KIESA-së. Në takim u paraqitën shqetësimet tona për mos fillimin e punimeve dhe kërkuam nga OE që të rifillojë punimet me intensitet të plotë dhe t'i përmbahet planit dinamik të punimeve. Këto vonesa e kanë pamundësuar KIESA-n të realizoj projektet e radhës dhe buxhetin e planifikuar, sipas ligjit të buxhetit. Përfaqësuesit e OE premtuan se punimet do të fillojnë që nga nesër me datën 27.02.2024 dhe se do të kryhen sipas planit dinamik.

Në vijim po paraqesim disa pjesë të raporteve nga datat e vizitave në teren, ku OE vazhdimisht ka punuar me intensitet të ulët:

Me datë **27.02.2024** OE ka rifjlluar punimet në projektin e lartcekur. Në cilësinë e menaxheres kam kërkuar nga OE që të rrisë kapacitetet në punë, në mënyrë që të mos kemi vonesa në realizimin e punimeve dhe të përmbahet plani dinamik sipas kontratës

Me datën **05.03.2024** ishim në vizitë në teren, ku shprehem shqetësimet tona, pasi punimet ishin duke vazhduar vetëm në gjurmimin e parcelave dhe jo në pozicione të tjera. Po në të njëjtën datë kemi njoftuar dhe OE si dhe kemi kërkuar që të rrisin kapacitetet e punimeve pasi që punimet ishin duke u kryer me kapacitet minimal.

Me datë **13.03.2024** bashkë me organin mbikëqyrës nga MINT, ishim në vizitë në projektin Ndërtimi infrastruktures në Parkun Industrial në Ofterushë. Punimet ishin duke vazhduar, por me kapacitet jo të plotë. Ne kërkuam nga menaxheri i punimeve, që të rrisin kapacitetet dhe të vazhdojnë punimet sipas planit dinamik, përndryshe do të merren masa sipas kontratës.

Me datë **05.04.2024** ishim në vizitë në teren ku OE përsëri ka vazhduar me dinamikë të njëjtë të punës. Nga ku dhe është kërkuar prape rritja e intensitetit të punimeve.

Me datë **12.04.2024** bashkë me organin mbikëqyrës nga MINT, si dhe me koleget bashkëpunëtoresh profesionale, ishim në vizitë në teren. Pas disa kërkesave për rritjen e kapaciteteve në punë, OE gjate kësaj jave kishte rritje të konsiderueshme të kapaciteteve. Ne kërkuam që të përmbahen planit dinamik.

Me datë **02.05.2024** ishim në vizitë, OE ishte duke punuar në disa pozicione, ne kërkuam që të vazhdohet me intensitet të lartë dhe të respektohet plani dinamik ose do të marrim masa sipas ligjit.

Me datë **27.05.2024** ishim në vizitë, përsëri kemi kërkuar që të rritet intensiteti i punës dhe të respektohet plani dinamik ose do të marrim masa sipas ligjit.

Me datë **25.06.2024** përsëri ishim në teren ku kemi theksuar që të rriten kapacitetet e punimeve duke pasur parasysh se planin dinamik ishte pothuajse në përfundim.

Me datë **27.06.2024** kemi njoftuar OE se jeni në përfundim të planit dinamik sipas kontratës nga 320 ditë pune deri më tani keni shfrytëzuar 287 ditë pune, që do të thotë keni vetëm edhe 33 ditë pune, kurse punimet ende nuk kanë filluar në disa pozicione, siç janë punimi i rrjetit të elektrikes, vendosjen e skajorëve, si dhe vendosjen e kubëzave, shtrimi i materialit guror 0-3 mm, përfundimi i rrjetit të ujës-jellës, një pjesë e rrjetit të kanalizimit fekale, përfundimi i rregullimit të skarpave, përfundimi i shtresës së gjeotekstit, si dhe shtrimi i materialit guror 0-60mm.

Me datë **05.07.2024** ishim në vizitë, ku kemi cekur se janë duke u punuar vetëm në disa pozicione dhe kemi kërkuar që të respektohet plani dinamik ose do të marrim masa sipas ligjit.

Me datë **23.07.2024** përsëri ishim në vizitë dhe e kemi cekur se janë duke u punuar vetëm në disa pozicione, ndërsa kemi kërkuar që të respektohet plani dinamik ose do të marrim masa sipas ligjit.

Me datë 29.07.2024 përmes emailit është arsyetuar se një ndër shkaqet e vonesave në punime është rrjeti elektrik, i cili për mes kësaj email-e ka kërkuar sqarime për zhvendosjen e rrjetit të elektrikes, ndërsa për pozicionet e kërkuara si punë shtesë, ne kemi theksuar dhe jemi dakorduar disa herë edhe gojarisht gjatë vizitave në teren, por edhe përmes email-eve zyrtare, që rrjeti mund të zhvendoset sipas nevojës dhe gjendjës në teren (e aprovuar nga projektuesi i projektit), ndërsa pozicionet tjera janë të parapara në projekt në fazën e dytë të ndërtimit.

Me datë 02.08.2024 në cilësinë e menaxheres së kontratës përmes email-it ju është shqiptuar vërejtje për arsye të neglizhencës së vazhdueshme në punë dhe ju është kërkuar që të rriten kapacitetet e punimeve, duke theksuar vazhdimisht që plani dinamik është në përfundim.

Me datë 08.08.2024 përsëri ishim në vizitë në teren, ku gjendja pothuajse ishte e njëjtë. Në teren ishte vetëm një punëtor, mjete të punës vetëm një ekskavator ndërsa menaxheri i projektit nga OE nuk na është lajmëruar as në telefon. Të gjitha datat e lartë cekura, e shumë vizita të tjera në teren, janë të dëshmuara me raporte dhe me foto nga terreni.

Me datë 04.09.2024 i'u është shqiptuar vërejtja e radhës e protokolluar, si rezultat i gjendjes në teren, ku edhe pas vizitave të njëpasnjëshme në teren dhe kërkesave tona për rritje të kapacitetit të punimeve, për mos angazhimin dhe neglizhencën e punimeve.

Theksojmë se plani dinamik i punimeve prej 320 ditëve ka përfunduar me datë 02.09.2024 ndërsa deri me 20.09.2024 kemi aprovuar ditë shtesë sipas kërkesës së OE dhe për arsye të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë për shkak të temperaturave të larta në sezonin veror. Po ashtu ne si AK duke marr parasysh gjendjen në teren, si dhe dëshirën për të përfunduar projektin me sukses, përsëri i kemi aprovuar OE ditë të tjera shtesë pa penallti.

Me datë 24.10.2024 kemi mbajtur takim në prezencë të ud. Sekretares së Përgjithshme në MINT, ud. i Drejtorit të Përgjithshëm në KIESA, Drejtori Drejtoratit për Zhvillimin e Sektorit Privat, Udhëheqësi i Sektorit të Zonave Ekonomike, Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit, ud. nga Zyra Ligjore, Organi Mbikëqyrës nga MINT, si dhe unë Menaxherja e projektit, me ç'rast është marrë vendim i përbashkët në qoftë se nuk do të ketë rritje te:

1. Të sjell një "zotim/deklaratë" më shkrim që është i gatshëm të realizoj projektin sipas kontratës dhe paramasës së nënshkruar me Ministrinë (pa mjete shtesë), brenda një afati të caktuar - plani dinamik që duhet të dërgoj OE se kur do të përfundoj projektin. Se bashku me këtë, të sjell edhe sigurimin.
2. Nëse operatori ekonomik nuk është i gatshëm të vazhdoj punimet sipas kushteve të kontratës (pikës 1), atëherë të sjell kërkesë për shkëputje të kontratës.
3. Nëse operatori ekonomik nuk është i gatshëm të ju përmbahet pikave të mësipërme (pikës I dhe 2), atëherë kemi deklaruar së nga ana e jonë do të iniciohen procedurat për shkëputje të njëanshme të kontratës.

Në takim, obligim i KIESA-së mbeti që deri me datë 12.03.2025 në fund të orarit të ju kthehet përgjigje sa i përket situacionit të dërguar me 24.02.2025, dhe pasi të sjellin sigurimin e ekzekutimit dhe faturën për situacionin të ju ekzekutohet pagesa e situacionit. Ne, në po të njëjtën datë ja kemi konfirmuar situacionin dhe kemi ri kërkuar që ta sjellin sigurimin e ekzekutimit. Ndërsa OE edhe pas mbajtjes së takimit nuk iu përmbajt asnjërës pikë që u dakorduar në takim.

Me datë 14.03.2025 e kemi njoftuar OE përmes emalit dhe kemi kërkuar që si përfundim i kësaj kontrate, brenda 30 ditëve kalendarike duke filluar nga data 17 mars 2025 (e hënë) duke ju referuar penalltive, që të përfundoj pUnët e mbetura sipas paramasës dhe kontratës së nënshkruar, në të kundërtën pas kësaj date ka zero tolerance, në po të njëjtën datë (me 17 mars) duhet të sjellin edhe sigurimin e ekzekutimit të punimeve, në të kundërtën do të marrim masa menjëherë konform Legjislacionit të prokurimit publik.

Me datë 17.03.2025 përmes emalit nga OE kemi pranuar një sigurim të ekzekutimit në vlerë prej: 52,021.70euro, gjë që nuk është konform kontratës së nënshkruar (nuk është 10% i vlerës së kontratës bazë). Menjëherë kemi reaguar përmes emalit duke njoftuar OE se sigurimi i sjellur është i papranueshëm dhe se duhet të silltet sigurimi sipas vlerës së kontratës bazë, sigurim i cili nuk u sjell nga OE. Përveç që nuk pranuan sigurimin, me datë **18.03.2025** OE parashtrij disa kushte të tjera për vazhdim të punimeve dhe sjelljen e sigurimit, edhe pse ato nuk ishin diskutuar në takim.

Pas pranimit të emalit të lartë shënuar nga OE me datë 18.03.2025, më datë **19.03.2025** kemi kthyer përgjigje që këto janë të papranueshme dhe ju duhet t'i përmbaheni emalit të datës **14.03.2025**, që punimet duhet të kryhen vetëm sipas kontratës si dhe ditët shtesë janë me dënime, pasi që nga **02.09.2024** e deri me **11.11.2024** ka pasur ditë shtesë që nuk janë aplikuar penalltitë. Por prapë se prapë OE nuk e ka marr seriozisht përfundimin e punimeve sipas kontratës.

Që nga data **19.03.2025** e deri me datë **28.03.2025** ishim në pritje të një përgjigje pozitive nga OE për fillim të punimeve si dhe sjelljen e sigurimit të ekzekutimit, mirëpo nuk ka ndodhur një gjë e tillë, as nuk kanë filluar punimet e as nuk e ka sjellur sigurimin sipas kontratës.

Me datë **28.03.2025** si rezultat i mos sjelljes së sigurimit dhe mos fillimit të punimeve nga OE, ne kemi mbajtur takim me ud. Sekretaren e Përgjithshme nga MINT, Udhëheqësin e Divizionit të Prokurimit, ud. i Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA-së, Drejtori i Drejtoratit për Zhvillimin e Sektorit Privat, si dhe Inxhinierët e KIESA-së dhe është marrë vendim unanim për shkëputjen e njëanshme të kontratës për projektin "**Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Oterushë**".

Pra, autoriteti kontraktues - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kërkon marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se, me arsyetimin se OE Pro&Co Group, nuk e ka përmbushur kontratën sipas kushteve të parapara.

Shqyrtimi i kërkesës dhe vlerësimi i pretendimeve të Autoritetit Kontraktues për marrjen e masave ndaj OE Pro&Co Group:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, Organi Shqyrtues i Prokurimit, konstaton se autoriteti kontraktues – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nuk ka dorëzuar asnjë provë që dëshmon se OE Pro&Co Group, në këtë aktivitet të prokurimit, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj operatorit ekonomik.

Bazuar në nenin 99.2 të LPP-së, Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: *“Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare”*, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE Pro&Co Group, për aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial Opterushë, me nr. të prokurimit: 204-22-12762-5-1-1.

Prandaj, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me mashtrim apo falsifikim sipas dispozitave të nenit 99.2 të LPP-se.

OSHP, konstaton se në rastin konkret, palet kontraktuale në kontratën e lidhur me datën: 13.03.2023, nuk kanë arritur të zgjedhin në mënyrë miqësore mosmarrëveshjet që kanë pasur dhe se sipas kushteve të veçanta të kontratës, palet mund të referohen Gjykatës kompetente, kusht ky i vendosur nga vet palet kontraktuale, të kushtet e veçanta të kontratës, në faqen nr. 24, konkretisht neni 43.1: *“Cdo mosmarrëveshje ndërmjet paleve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndërmjet paleve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente në pajtim me ligjin në Kosovë”*.

Pa nevojë për sqarime tjera shtesë, OSHP vlerëson se Autoriteti Kontraktues të drejtën e tij kontraktuale mund të realizojë sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) pranë Gjykatës kompetente.

Duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me padë mund t'i
drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne
afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
- 1x1 OE - Pro&Co Group
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

